



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



API

Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

PLANI I PERFORMANCËS 2026

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +381 38 200 36 554

Web: www.kipa.rks-gov.net

Hyrje

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe është institucioni i vetëm i ngarkuar në Kosovë për administrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale, detyrim i cili buron nga neni i 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në bazë të Ligjit për Patenta Nr. 08/L-059, API është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave për lëshimin e patentave, marka tregtare, dizajnëve industriale, topografive të qarqeve të integruara dhe treguesit gjeografikë. API po ashtu është mandatarë për zhvillimin dhe promovimin e pronësisë industriale dhe rregullimin e fushës ligjore të pronësisë industriale.

Sipas buxhetit të miratuar për vitin 2026, API ka të buxhetuar 13 zyrtarë dhe ka një buxhet prej 209,861.00 euro të ndara në paga dhe shpenzime për shërbimet.

Stafi i Agjencisë për Pronësi Industriale përbëhet nga 10 zyrtarë përfshirë dhe Drejtorin Ekzekutiv.

Infrastruktura ligjore me të cilën vepron Agjencia përbëhet nga Ligjet dhe Udhëzimet Administrative:

- Ligji nr. 08 L-075 për Markat Tregtare;
- Ligji nr. 08 L-076 për mbrojtjen e Sekreteve Tregtare;
- Ligji nr. 08 L-053 për Topografitë e Gjysmëpërçuesve;
- Ligji nr. 08 L-055 për Dizajnin Industrial;
- Ligji nr. 08 L-059 për Patentat;
- Ligji nr. 05 L-051 për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës;
- Rregullore nr. 21/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnëve Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02-2023 për Procedurën e Regjistrimit të Topografive;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01-2023 për Caktimin e Taksave për Shërbimet e ofruara nga Agjencia për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14-2022 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13-2022 për Përfaqësues të Autorizuar për Pronësinë Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 10-2022 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisioni të Ankesave kundër Vendimeve të API-së;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05-2022 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimin e Logos së API-së;
- Rregullore Nr. 01-2020 e punës për Komisionin e Ekspertëve për Produkteve Bujqësore dhe Artikujt Ushqimore;

- Udhëzimi Administrativ Nr. 09-2018 për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimet e Origjinës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 11-2016 për Treguesit Gjeografikë.

Agjencia për Pronësi Industriale është përgjegjëse dhe mban rolin primar në zbatim të Kapitullit VII të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, i cili obligon Kosovën për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Sipas Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027 prioritetet e përcaktuara janë: Ngritja e resurseve humane pranë API-së, krijimi i Divizionit të Promovimit dhe atij Juridik; ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Agjencisë për Pronësi Industriale, Miratimi i Strategjisë për Pronësi Industriale; Rritja e kapacitetit dhe koordinimit të institucioneve politikbërëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; ngritja e vetëdijes së NVM-ve mbi rëndësinë e pronësisë industriale; anëtarësimin e Kosovës në WIPO dhe EPO.

Sipas Planit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027, Agjencia për Pronësi Industriale është e obliguar të bëjë përmirësimin e mbrojtjes së pronësisë industriale. Për këtë tregues janë parashikuar veprimet strategjike si në vijim: Digjitalizimi i proceseve të ekzaminimit të objekteve të pronësisë industriale Implementimi softwerit të ri IPAS përmes WIPO; Përgatitja e një plani për implementimin e aplikimeve online; Ngritja e kapaciteteve administrative të zyrtarëve të API-së dhe profesionistëve në fushën e pronësisë industriale; Identifikimi i produkteve bujqësore vendore me potencial për t'u regjistruar si tregues gjeografikë dhe emërtime të origjinës; Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e pronësisë industriale; Aplikimi në WIPO dhe ratifikimi i konventës së Parisit; Ngritja e vetëdijes për pronësi industriale - rritja e numrit të aplikimeve për patenta dhe dizajnë industrialë; Vlerësimi i pronësisë industriale tek kompanitë inovative, Implementimi i IpScan tek kompanitë me potencial inovativ.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin për Pronësi Industriale 2025-2027, si një dokument strategjik i cili është në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA), duke synuar të sigurojë mbrojtje efektive dhe adekuate të të drejtave të pronësisë intelektuale, ashtu siç ndodh në sistemin e BE-së. Ky program synon fuqizimin e Sistemit të Pronësisë Industriale në Kosovë duke ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare dhe ka për qëllim nxitjen e rritjes ekonomike, zhvillimit social dhe teknologjik, si dhe përmirësimin e respektit për të drejtat e pronësisë industriale.

Aplikimet për regjistrimin e objekteve të pronës industriale

Numri i aplikimeve për marka tregtare ka shënuar rritje krahasuar me raportin e fundit të vitit 2024, dhe ky trend vazhdon edhe gjatë vitit 2025. Nga raportet vjetore dhe të dhënat mbi aplikimet e pranura vërehet një rritje e aplikimeve vendore për mbrojtjen e markave tregtare. Ky trend rritës i aplikimeve vendore dëshmon se aktivitetet e Agjencisë për promovimin e rëndësisë së mbrojtjes së pronësisë industriale kanë dhënë rezultate konkrete dhe të matshme. Sipas të dhënave zyrtare të

regjistrave të Agjencisë për Pronësi Industriale, deri më tani janë paraqitur gjithsej 43,589 aplikime për marka tregtare.

Numri i aplikimeve për patenta mbetet i ulët, kryesisht për shkak të mungesës së anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), si dhe për shkak të zhvillimit të kufizuar të industrisë inovative që lidhet drejtpërdrejt me aplikimet për patenta nga shpikësit vendorë. Me anëtarësimin e Kosovës në EPO pritet një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve, pasi kostot financiare dhe koha e procedurës do të reduktohen në raport me sistemin aktual të mbrojtjes kombëtare. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrave të Agjencisë për Pronësi Industriale, deri më tani janë paraqitur gjithsej 2,450 aplikime për patenta.

Numri i aplikimeve për dizajne industriale në Kosovë mbetet dukshëm i ulët, gjë që lidhet drejtpërdrejt me nivelin ende të kufizuar të zhvillimit industrial dhe kreativ në vend. Deri më tani, sipas të dhënave të regjistrave të Agjencisë për Pronësi Industriale, janë paraqitur gjithsej 498 aplikime për dizajne industriale. Mungesa e kapaciteteve për zhvillimin dhe komercializimin e produkteve të reja, si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë ekonomike të dizajnit industrial, ndikojnë negativisht në kërkesën për këtë formë mbrojtjeje.

Agjencia për Pronësi Industriale ka regjistruar Emërtimin e parë të origjinës në Kosovë, "Djathin e Sharrit" dhe verëra 'Rahoveci' si produkte vendore. Pas këtyre regjistrimeve, nuk janë pranuar aplikacione të reja për tu mbrojtur sipas Ligjit për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtime të Origjinës.

Nga raporti i kaluar paraprak vjetor dhe të dhënave të nxjerra nga sistemi IPAS, janë lëshuar 8716 dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve dhe janë publikuar 8 buletine me 4397 objekte të pronësisë industriale.

Për menaxhimin e regjistrave për Patenta, Marka Tregtare, Dizajnë Industrial, Tregues Gjeografik dhe Emërtime të Origjinës apo objekteve të pronës industriale, Agjencia për Pronësi Industriale shfrytëzon sistemin IPAS të dhuruar dhe mirëmbajtur nga WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale). Ky sistem përbëhet nga 3 komponentë si WipoScan, WipoPublish dhe WipoManager. Të gjitha lëndët e pranuar nga Agjencia për Pronësi Industriale skanohen dhe indeksohen/protokolohen në sistemin IPAS (Sistemi Automatik Pronësisë Industriale).

Aplikimet e pranuar publikohen në Buletinin Zyrtar të Agjencisë dhe janë të aksesueshme në faqen zyrtare të API-së. Gjithashtu, Agjencia disponon një regjistër elektronik online, në të cilin palët e interesuara kanë qasje të lirë. Ky regjistër u mundëson përdoruesve të kryejnë kërkime për marka tregtare dhe të ndjekin statusin e aplikimeve të tyre. Ofrimi i këtij shërbimi garanton transparencë të plotë nga ana e Agjencisë, pasi aplikuesit mund të verifikojnë në çdo kohë fazën e procedimit të aplikimit të tyre.

Agjencia për Pronësi Industriale disponon faqen e saj zyrtare në internet në adresën www.kipa.rks-gov.net. Në këtë platformë publikohen të gjitha aktivitetet e Agjencisë, aplikacionet për regjistrimin e

objekteve të pronësisë industriale, Buletini Zyrtar, si dhe informacione të tjera relevante lidhur me objektet e pronësisë industriale.

Plani i Performancës për vitin 2026 synon forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e shërbimeve të Agjencisë për Pronësi Industriale (API) për mbrojtjen efektive të inovacionit dhe kreativitetit në sistemin kombëtar të pronësisë industriale. Fokusi i planifikuar operacional ndahet në katër shtylla kryesore, të cilat shërbejnë si bazë për arritjen e objektivave strategjike gjatë periudhës njëvjeçare.

Shtylla e parë përqendrohet në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të regjistrimit, me qëllim uljen e kohës së shqyrtimit të aplikimeve dhe trajtimin rritës të numrit të objekteve të pronësisë industriale. Në këtë kuadër, planifikohet trajtimi i lëndëve të pranuar, nxjerrja e vendimeve dhe dokumenteve përfundimtare, publikimi i rregullt i Buletinit Zyrtar, projektimi dhe implementimi i platformës elektronike për aplikime, si dhe avancimi i bazës së të dhënave për kërkim dhe verifikim publik.

Shtylla e dytë ka në fokus zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit, përmes rekrutimit të zyrtarëve të rinj dhe organizimit të trajnimeve të specializuara në fushën e patentave, markave dhe dizajneve industriale. Përforcimi i njohurive teknike dhe juridike synon rritjen e cilësisë së vendimmarrjes, uljen e afateve të procedimit dhe harmonizimin me praktikën e EUIPO dhe WIPO. Po ashtu, do të realizohet funksionalizimi i divizioneve të reja dhe ngritja e kapaciteteve të Komisionit të Ankesave.

Shtylla e tretë synon nxitjen e kulturës së mbrojtjes së pronësisë industriale në mesin e bizneseve vendore, përmes organizimit të fushatave informuese dhe edukative në shkolla, universitete dhe oda ekonomike, pjesëmarrjes në panaire dhe aktivitete publike, shënimit të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe promovimit të mbrojtjes përmes mediave digjitale. Po ashtu, planifikohet nxitja e mbrojtjes së treguesve gjeografikë dhe operacionalizimi i shërbimeve mbështetëse për auditimin e aseteve industriale të ndërmarrjeve inovative.

Shtylla e katërt fokusohet në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, përmes anëtarësimeve, marrëveshjeve institucionale dhe angazhimit në projekte rajonale e globale me organizata si WIPO, EUIPO dhe CEFTA. Në këtë kuadër, synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrtarë partnerë, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitimi nga asistencë teknike dhe digjitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, planifikohen veprime institucionale për adresimin e mungesës së country code të Kosovës në sistemin e EUIPO, për të mundësuar aplikimin e bizneseve vendore për marka europiane.

					shfuqizimin e markave tregtare dhe revokimeve pas formimit të sektorit Juridik; 6. Vazhdimi i trajtimit të kërkesave për kundërshtimin e markave tregtare; 7. Avancimi i bazës së të dhënave dhe sistemit të kërkimit publik për identifikimin dhe verifikimin e statusit të mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale.		
Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të API-së	Numri i trajnimeve të zyrtareve të Agjencisë dhe numri zyrtarëve të rekrutuar	1. 3 trajnime 2. 0 zyrtare te rekrutuar	1. 4 trajnime 2. 2 zyrtare te rekrutuar	Përfundimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve administrativ e dhe rekrutimi i stafit	1. Organizimi i trajnimit për shqyrtimin e kërkesave për shfuqizim dhe revokim të markave tregtare. 2. Trajnimi i stafit për zbatimin e kriterëve të refuzimeve absolute në procedurat e markave tregtare. 3. Trajnimi në fushën e dizajnit industrial, me fokus në vlerësimin e risisë dhe analizës së saj. 4. Ngritja e kapaciteteve të Komisionit të Ankesave përmes trajnimeve sipas praktikës së	20,000.00 euro (sipas buxhetit të vlerësuar 2026) Projekti Zviceran CEFTA - EUIPO	Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027 Plani Kombëtar për Zhvillim 2025-2027 Programi për Pronësi Industriale 2025-2027

					EUIPO-së dhe ligjislacionit vendor. 5. Funksionalizimi Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Promovim të pronësisë industriale dhe Divizioni për Çështje Administrative të pronësisë industriale; përmes trajnimeve dhe ndarjes së roleve operative. 6. Trajnimi bazë dhe i avancuar i stafit të ri të rekrutuar në fushën e pronësisë industriale. 7. Përfshirja aktive e API-së në konferenca, trajnime dhe workshop-e ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave dhe harmonizimin me standardet e EUIPO/WIPO.		
Nxitja e kulturës së mbrojtjes së pronësisë industriale përmes rritjes së aplikimeve për marka dhe patenta nga subjekte vendore	Numri i aktiviteteve të organizuara	5 aktivitete të organizuara	8 aktivitete të organizuara	Aktivitete të realizuara sipas planit vjetor të API-së.	1. Organizimi i fushatave informuese dhe edukative mbi pronësinë industriale në shkolla dhe universitete; 2. Pjesëmarrja aktive në fushata, manifestime dhe panaire të odave ekonomike për promovimin e pronësisë	25,000.00 euro (sipas buxhetit të vlerësuar 2026) Projekti Zvicëran	Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027

					industriale në komunitetin e biznesit; 3. Organizimi i aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelktuale; 4. Promovimi i pronësisë industriale përmes mediave elektronike dhe platformave digjitale; 5. Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për mbrojtjen dhe regjistrimin e treguesve gjeografikë; 6. Operationalizimi i shërbimit për vlerësimin dhe auditimin e pronësisë industriale në ndërmarrjet inovative si pjesë e mbështetjes për zhvillimin e ekosistemit të inovacionit	CEFTA - EUIPO	Plani Kombëtar për Zhvillim 2025-2027 Programi për Pronësi Industriale 2025-2027
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e pronësisë industriale përmes anëtarësimeve, marrëveshjeve institucionale dhe projekteve me	Numri i aktiviteteve me këto organizata	0	2	Marrëveshja e nënshkruar	1. Nënshkrimi i së paku një marrëveshjeje bashkëpunimi me një zyrë ndërkombëtare të autorizuar për ekzaminimin substancial të patentave; 2. Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta me EUIPO brenda kornizës së CEFTA për	20,000.00 euro (sipas buxhetit të vlerësuar 2026)	Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027 Plani Kombëtar

organizatat relevante si WIPO, EUIPO dhe zyrat rajonale.					harmonizimin rajonal dhe ngritjen e kapaciteteve; 3. Vazhdimi i bashkëpunimit me WIPO për ngritjen e kapaciteteve në teknologjinë informative dhe zhvillimin e sistemeve digjitale të API-së; 4. Ndërmarrja e veprimeve institucionale për adresimin e mungesës së country code të Kosovës në sistemin e EUIPO dhe mundësimin e aplikimit të bizneseve vendore për marka tregtare europiane.	Projekti Zviceran CEFTA - EUIPO	për Zhvillim 2025-2027 Programi për Pronësi Industriale 2025-2027
--	--	--	--	--	--	--	--

Plani Kohor për realizimin e aktiviteteve

Objektivi 1 – Për realizimin e këtij objektivi Agjencia punon në baza ditore sipas mandatit të saj. Gjatë vitit 2026 duhet të fillohet me shqyrtimin përmbajtësor të shfuqizimeve të markave tregtare dhe revokimeve pasi gjatë vitit 2025 janë proceduar ftesat formale për përgjigje. Ky aktivitet lidhet ngushtë dhe me formimin e Divizioni për Çështje Administrative të pronësisë industriale që sipas Rregullores është përgjegjës për realizimin e këtij aktivitetit. Gjithashtu, reformat në teknologjinë informative varen nga mbështetja e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), e cila është ofruesja dhe mirëmbajtësja e sistemit IPAS, ndaj dinamika e zbatimit të këtij komponenti do të përcaktohet në koordinim me këtë organizatë.

Objektivi 2 – Për realizimin e këtij objektivi dhe aktiviteteve përkatëse, Agjencia për Pronësi Industriale do të shfrytëzojë mbështetjen nga projektet e donatorëve, trajnimet online të ofruara nga organizatat ndërkombëtare si EUIPO dhe EPO, si dhe mundësitë për ngritje kapacitetsesh që burojnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit me zyrat rajonale. Për shkak se API nuk disponon një listë paraprake të programeve të trajnimit të planifikuara nga këto organizata, nuk është e mundur të përcaktohen në këtë fazë periudha kohore të sakta për secilin aktivitet. Megjithatë, implementimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve do të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit 2026.

Objektivi 3 – Për realizimin e aktiviteteve për arritjen e këtij objekti, Agjencia do të shpallë muajin Prill si muaj të promovimit të të drejtave të pronësisë industriale dhe shumica e aktiviteteve promovuese me media elektronike apo me biznese do të realizohen në këtë muaj, pra në periudhën TM2.

Objektivi 4 – Ky Objektiv mbetet sfidues, Agjencia do të angazhohet aktivisht në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me zyra ndërkombëtare të patentave, realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me EUIPO në kuadër të CEFTA-s, vazhdimin të bashkëpunimit me WIPO në fushën e teknologjisë informative dhe ndërmarrjes së veprimeve për adresimin e mungesës së country code të Kosovës në sistemin e EUIPO.

KONTAKTI



Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojino
Industrial Property Agency

MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë / Republika e Kosovës

Website: www.kipa.rks-gov.net

E-mail: infoapi@rks-gov.net

Tel: +383 38 200 36 554 /36 526

Orari i pritjes: E hënë – E premte 08:30 - 15:30